

NP "HIGJIENA KOMUNALE" U PAJIS ME KATËR KAMIONË TË RINJ PËR MBETURINA



NDËRTOHET KORSIA E PATINAVE-BIÇIKLETAVE NË ANËN E MAJTË TË LUMIT VARDAR



„SHKUP“

LAJMËTARI INFORMATIV I
QYTETIT TË SHKUPIT

Numri i parë i lajmëtarit informativ
„Shkupi“ u botua më:
10 dhjetor 2008

Kryeredaktor
Nedelčo Krstevski

Zëvendës kryeredaktor
Elena Kuzmanovska

Redaksia
Seksioni për marrëdhënie me
opinionin

Redaktor i fotografisë
Radomir Jovanović

Përkthyes dhe lektor
Vladimir Bogdanovski

BOTON QYTETI I SHKUPIT
për botuesin
Kryetari i Qytetit
Koce Trajanovski
Bulevardi Ilindenska p.n.

Telefon
02 3297 255
02 3297 265

e-mail adresa
mediumi@skopje.gov.mk
gragjani@skopje.gov.mk

Dizajni:
Evropa 92 - Koçanë

Qyteti i Shkupit realizoi një aksion të madh një ditor për mbulimin e gropave

NJËQIND E TRIDHJET E RRUGËVE



TË TON ASFALT PËR RIPARIMIN

Gropat në 18 rrugë të qytetit dhe bulevarde u mbuluan me asfalt në aksionin e madh për riparimin e rrugëve që të dielën, më 1 nëntor, e realizuan ekipet e Qytetit të Shkupit. Aksioni për riparimin e asfaltit të dëmtuar në të njëjtën kohë u zhvillua në të gjitha komunat e Shkupit, për të cilin u angazhuan katër firma ndërtimi.

- Në këtë aksion të madh për mbulimin e gropave të rrugëve në 18 rrugë të qytetit dhe bulevarde të cilat janë nën kompetencat e Qytetit të Shkupit do të harxhohen rreth 130 ton asfalt dhe do të mbulohen rreth 1.000 metër katror rrugë. Për mbulimin e gropave në këtë aksion Qyteti i Shkupit shpenzoi gjashtë milion denarë. Shkaku për të cilin u realizua ky aksion i madh të dielën është volumni i zvogëluar i qarkullimit në qytet – tha kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski, në fillim të aksionit për mbulimin e gropave.

Ekipet e firmës “Izolacija” të dielën punuan në rrugët L Lazar Lipçenovski dhe Samoilova, si dhe në bulevardin Ilinden, nga Kopshti zoologjik deri në rrugën Nikolla Parapunov, në bulevardin Nikolla Karev, nga rruga Shkupi deri në dalje të Shkupit në Hipodrom dhe në bulevardin 8 Shtatori.

Punëtorët e firmës “Bauer” mbuluan gropat në bulevardet Xhon Kenedi dhe Brigada Maqedonase-Kosovare dhe në rrugët Llazo Trpovski dhe Shuto Orizari.

Firma e ndërtimit “Pelagonia” punoi në rrugët Gjorçe Petrov, 4 Korriku dhe Socialistička Zora.

Ekipet e NP “Rrugë dhe rrugica” asfaltuan gropat e bulevardit Partizanski odredi, nga Tempulli ortodoks deri në kryqëzimin me bulevardin 8 Shtatori, rrugët Maxhari, Marioska, Atanas Mitrev dhe në rrugën e Inxhikovës, si dhe në bulevardin Shën. Kliment Ohridski.



NDËRTOHET KORSIA E PATINAVE-BIÇIKLETAVE NË ANËN E MAJTË TË LUMIT VARDAR



Korsia e patinave-biçikletave me gjatësi 1800 metra do të lidhë Urën e Gurit dhe fabrikën “Komuna”, në anën e majtë të bregut të lumit Vardar. Startin e ndërtimit të kësaj korsie e shënoi kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, më 30 tetor.

- Korsia do të jetë e gjatë 1.800 metra, kurse e gjerë katër metra. Për punët përgatitore dhe për ndërtimin e korsisë do të shpenzohen 8 milion denarë, investim i Qytetit të Shkupit, kurse në terren do të punojnë ekipet e “Mavrovo inxhiniering”. Kjo është faza e parë e ndërtimit të korsisë të patinave-biçikletave në anën e majtë të lumit Vardar. Vitin e ardhshëm do të punojmë në pjesën e dytë të kësaj korsie, nga fabrika “Komuna” deri te ura “Binjaku” si dhe në pjesën e tretë të korsisë, nga Ura e Gurit drejt hotelit “Aleksandar Palas”. Shpresojmë se vitin e ardhshëm anën e majtë të bregut të lumit Vardar do ta rregullojmë plotësisht dhe qytetarët do të mund të lëvizin lirisht nëpër të. Paralelisht me ndërtimin e kësaj korsie të patinave-biçikletave do të punojmë edhe në fushata për ngritjen e vetëdijes publike për shfrytëzimin e biçikletës si mjet alternativ transporti – tha kryetari i Qyteti të Shkupit, Koce Trajanovski, gjatë vizitës në korsinë në breg.

Përgjatë korsisë së patinave-biçikletave në anën e majtë të lumit Vardar do të vendosen bordura betoni. Për ndërtimin e rrugës do të përdoret një shtresë tampon dhe përzjerje asfalti dhe betoni AB 11. Korsia do të shënohet me sinjalizim horizontal dhe vertikal.

NP "HIGJIENA KOMUNALE" U PAJIS ME KATËR KAMIONË TË RINJ PËR MBETURINA

Ndërmarrja publike "Higjiena komunale" muajin e kaluar u pajis me katër kamionë të rinj të specializuar për grumbullimin e mbeturinave. Kamionët e rinj kanë një vëllim prej 16 metra kub, me mekanizëm për ngritjen dhe zbrazjen e kontejnerëve standardë me vëllim prej 1,1 kubik dhe kova prej 120 dhe 240 litra. Ekziston edhe mundësia për drejtimin automatik dhe manual të ciklit të punës.

- Kamionët e rinj do të përmirësojnë në mënyrë të ndjeshme punën e NP "Higjiena komunale". Përgatisim dhe tender për furnizimin me 12 kamionë me të cilët shpresojmë se kjo ndërmarrje publike do të pajiset plotësisht. Me kamionët e rinj do të zvogëlohen shpenzimet e tanishme të ndërmarrjes publike që investohen në riparime të vazhdueshme të automjeteve. Bëjmë edhe punë të rëndësishme për përmirësimin e funksionimit të depos "Drisla" për mbledhjen e ujërave fekale si dhe për mbulimin e mbeturinave të deponuara. Me këtë japim një sinjal të qartë se qëllimi ynë është NP "Higjiena komunale" të funksionojë me sukses dhe se higjiena në qytet është prioriteti ynë – tha kryetari

i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski në promovimin e kamionëve të rinj.

Në tenderin që shpalli NP "Higjiena komunale" si më e mirë u zgjodh oferta e "Resor" nga Nishi e cila bëri furnizimin me automjete dhe bëri plotësimin me presë hidraulike dhe me mekanizmin për ngritjen kontejnerëve. Deri në fund të vitit 2009 do të bëhet furnizimi edhe me dy automjete që janë pjesë e së njëjtës porosi.

Muajin e kaluar katër kamionët e rinj u regjistruan dhe brenduan. Automjetet

janë të markës "Iveco" me motor euro 4 dizel dhe sisteme frenimi ABS, ASR. Çmimi i një automjeti komunal pa TVSH është rreth 5 milion denarë, kurse çmimi i të gjashtë kamionëve pa TVSH është rreth 32 milion denarë. Automjetet do të paguhen në 48 kështe prej 100,551 denarë. Në furnizimin me automjete të reja Qyteti i Shkupit mori pjesë me rreth 16 milion denarë të cilat u dhanë për pjesëmarrje. Automjetet janë marrë me lizing, me kontratë të nënshkruar me NBL Lizing.





U vendosën linja të reja të NQP „Shkup“

3B DHE 22A LIDHËN LAGJET VARDARISHTE DHE DAME GRUEV ME QENDRËN KLINIKE

Linja e re e autobusit me numër 3B, e NQP “Shkup” nga data 27 tetor lidhi lagjen Vardarishte në komunën Gazi Baba me Qendrën klinike.

- Me kërkesë të qytetarëve të lagjes Vardarishte e lëshojmë në provë në qarkullim linjën me numër 3B. Ky autobus që do të qarkullojë deri te Qendra klinike do të zgjidhë problemet shumëvjeçare me transportin publik të rreth 5000 banorëve në këtë pjesë të qytetit. Qyteti i Shkupit nëpërmjet subvencioneve do të ndihmojë funksionimin e kësaj linje, edhe pse ajo nuk është rentabile. Por, Qyteti i Shkupit është i obliguar të sigurojë transport publik në kohë dhe me kualitet në të gjitha pjesët e qytetit deri në qendër. Autobusi me numër 3B do të qarkullojë sipas një orari të caktuar udhëtimi, me theks në orët e mëngjesit dhe të pasdites, pikërisht kur qytetarët shkojnë dhe kthehen nga puna - tha kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, në promovimin e linjës 3B.

Autobusët në linjën me numër 3B në drejtimin Qendra klinike-Tregu kvantashki do të qarkullojë sipas këtij orari:

- Nisje e automjeteve nga Qendra Klinike në orën: 6.00; 7.20; 8.40; 10.00; 11.20; 12.40; 14.00; 15.20; 16.40; 18.00

dhe 19.15.

Nisje nga tregu kvantashki në orën: 6.40; 8.00; 9.20; 10.40; 12.00; 13.20; 14.40; 16.00; 17.20 dhe 18.40. Automjetet në linjën me numër 3B do të shërbejnë stacioneve të autobusëve të cilat gjenden në trasenë e linjës duke filluar nga Qendra klinike, bulevardet Vodnjanska dhe Shën. Kliment Ohridski, rrugët Dimitire Çupovski, 11 tetori, bulevardet Koço Racin, Kuzman Josifovski Pitu, Jane Sandanski, Vidoe Smilevski Bato, ASNOM, Vojvodina dhe nëpër rrugën Pero Nakov deri në hyrjen e Tregut kvantashki. Në drejtimin e kundërt, automjetet do të qarkullojnë nëpër të njëjtën trase.

Nga muaji i kaluar me Qendrën klinike u lidh edhe lagjja Dame Gruev, me linjën e autobusit 22A. Autobusët e linjës 22A do të qarkullojnë sipas këtij orari:

- Nisja e automjeteve nga Qendra klinike në orën: 6.40; 8.00; 9.20; 10.40; 12.00; 13.20; 14.40; 16.00; 17.20; 18.40 dhe 20.00

Nisja e automjeteve nga lagjja Dame Gruev në orën: 6.00; 7.20; 8.40; 10.00; 11.20; 12.40; 14.00; 15.20; 16.40; 18.00; dhe 19.20. Automjetet e linjave me numër 22A do të shërbejnë stacioneve të autobusëve të cilat gjenden në trasenë e linjës duke filluar



nga Qendra klinike, bulevardet Vodnjanska, Shën. Kliment Ohridski, Partizanski odredi dhe nëpër rrugën Luka Gerov deri në lagjen Dame Gruev – e vjetra e fundit 22 (rruga Novoselska). Në drejtimin e kundërt, automjetet do të qarkullojnë në të njëjtën trase.

NQP “Shkup” ndryshoi orarin e udhëtimit të linjës me numër 59, në drejtimin Karposh III-varreza Butel-lagjja Kuçevishka Bara. Orari i udhëtimit ekzistues i autobusit 59 do të mbahet deri në orën 18.30, kurse pastaj traseja ndryshon dhe në vend që autobusët të qarkullojnë nëpër rrugët Boca Ivanova dhe Gvadalajara, autobusët do të qarkullojnë nëpër rrugën Aleksandar Urdarevski (nëpër tregun në Butel).

Orarin e udhëtimeve për linjat e reja të autobusit qytetarët e interesuar mund ta lexojnë edhe në Internet-portalin e NQP www.jsp.com.mk.

Për përmirësimin e furnizimit me ujë

RIKONSTRUKTOHEN 1800 METRA TË RRJETIT TË UJËSJELLËSIT NË LAGJEN LISIÇE E EPËRME

Ekipet e Qytetit të Shkupit rikonstruktojnë 1800 metra të rrjetit të ujësjellësit në rrugët Gornovranovska dhe Bozhin Nikollov, në lagjen Lisiçe e Epërmet. Rrjeti i ujësjellësit në këto dy rrugë filloi të rikonstruktohet në mesin e muajit të kaluar, kurse punët në terren deri tani zhvillohen sipas dinamikës së parashikuar.

- Qëllimi i këtij projekti është që të realizohet rikonstruksioni i plotë i rrjetit të ujësjellësit në këtë pjesë të qytetit, kurse tubat ekzistues të zëvendësohen me profile më të mëdha. Fillojmë me pjesën e gjatë 1.8000 metra për të cilën parashikojmë të rikonstruktohet për 60 ditë. Pastaj vazhdojmë me rikonstruksionin e rrjetit të ujësjellësit në rrugë të tjera. Ky projekt në një masë të madhe do të përmirësojë kushtet për jetesë në Lisiçen e Epërme – tha kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, në startin e rikonstruksionit të rrjetit të ujësjellësit në Lisiçen e Epërme.

Rikonstruksionin e rrjetit të ujësjellësit në rrugët Gornovranovska dhe Bozhin Nikollov do ta kryejnë ekipet e "Energomont", nën mbikëqyrjen e specialistëve të NP "Ujësjellës dhe kanalizim".





KONFERENCA E PARË DONATORE PËR RIVITALIZIMIN E KANIONIT "MATKA"

Përfaqësues të institucioneve shtetërore, të përfaqësive diplomatike në vendin tonë dhe sektorit të biznesit më 22 tetor kishin mundësi të njihen me bukuritë e kanionit Matka, biodiversitetin specifik të këtij rajoni të mbrojtur dhe mundësitë për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, në konferencën donatore për kanionin "Matka" të cilën e organizoi Qyteti i Shkupit dhe organizata joqeveritare "Fagrikom".

- Prej nesh pritet të jemi të përgjegjshëm, të vëmendshëm dhe të kujdesshëm ndaj natyrës, sepse vetëm së bashku mund të ruajmë shumëllojshmërinë biologjike dhe të pasurojmë kualitetin e jetës për ne dhe për gjeneratat e ardhshme. Mbrojtja e kanionit Matka dhe promovimi i turizmit të qëndrueshëm është imperativ për Qytetin e Shkupit dhe ne edhe në të ardhmen do të punojmë fuqimisht për rivitalizimin e këtij margaritari të natyrës – tha kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, në fillim të konferencës donatore.

Mjetet që do të mbledhen në këtë konferencë donatore do të shfrytëzohen për realizimin e propozim-programit të Qytetit të Shkupit dhe të OJQ "Fagrikom" për zhvillimin e ekoturizmit në kanionin "Matka". Programi, ndërmjet të tjerash, parashikon rregullimin dhe promovimin turistik të parkut speleologjik, zhvillimin dhe promovimin e sporteve ekstreme alpinistike, mbrojtjen e shpellave dhe rregullimin e tyre dhe edukimin shkencor dhe animimin e vizitorëve.

RINOVOHET KORSIA PËR BIÇIKLETA NË KOMUNËN AERODROM

Kolona e biçikletave e cila qarkullonte nga marka "Vero" në Aerodrom, nëpër bulevardin Jane Sandanski deri në Qendrën transportuese dhe prapa, drejt qendrës tregtare "Biser" shënoi promovimin e korsisë së parë të shënuar për biçikleta në komunën Aerodrom. Korsia muajin e kaluar në mënyrë solemne u lëshua në përdorim nga kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, ministri për ambientin jetësor dhe planifikimin hapësinor, Nexhati Jakupi, ambasadorja e mbretërisë Holandeze në vendin tonë, Simone Filipini dhe kryetari i komunës Aerodrom Ivica Konevski.

- Qyteti i Shkupit do të vazhdojë me ndërtimin e korsive për biçikleta edhe në komunat e tjera. Paralelisht me këto aktivitete do të zhvillohet edhe fushata për ngritjen e vetëdijes publike për shfrytëzimin e biçikletës, jo vetëm si mjet për rekreim, por edhe si mjet alternativ transporti – deklaroi



kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski gjatë promovimit të korsisë së biçikletave në Aerodrom.

Në fund të kolonës së biçikletave para qendrës tregtare "Biser" u mbajt program

kulturor artistik me lojë shpërblyese në të cilën u ndanë 15 biçikleta – 8 publikut, kurse 7 nxënësve nga komuna Aerodrom të cilët tregojnë sukses të shkëlqyer në kontinuitet.

PROMOVOHET TRENI TURISTIK I SHKUPIT

Treni turistik i Shkupit nga muaji i kaluar është në dispozicion për të gjithë qytetarët e interesuar dhe për turistët. Treni do të qarkullojë nga sheshi "Maqedonia" nëpër korsinë për këmbësorë në bregun e lumit Vardar, nën urën "Goce Delçev" nëpër korsinë pas stadiumit "Filipi i Dytë" deri në Luna Park dhe nëpër të njëjtin drejtim do të kthehet prapa, në shesh.

Treni do të qarkullojë vetëm për fund javët, kur kushtet atmosferike do të jenë të volitshme.

- Më gëzon veçanërisht shumë fakti i vendosjes së sërishme të këtij treni, i cili përfaqëson një traditë të bukur të Shkupit dhe që qytetarëve, para së gjithash fëmijëve, do tu mundësojë edhe një mundësi për zbavitje – tha kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, në promovimin e trenit turistik.

DEPËRTOHET 700 METRA NGA ZGJERIMI I BULEVARDIT SERBIA

Janë depërtuar 700 metrat e parë nga zgjerimi i bulevardit Serbia, nga kryqëzimi me bulevardin Vidoe Smilevski Bato, drejt kryqëzimit me bulevardin Brigada e 3-të maqedonase. Ekipet e Qytetit të Shkupit në periudhën e kaluar realizuan pjesën më të vështirë të punës, gërmimet e dheut dhe hapjen e trasesë së rrugës së re, kurse këto ditë po kryhet tamponimi i rrugës.

Pas përfundimit të tamponimit, nga mesi i këtij muaji duhet të fillojë asfaltimi i kësaj pjese. Në trasenë e re po vendosen edhe bordura. Paralelisht me depërtimin e rrugës, është kryer kanalizimi sekondar atmosferik për vendosjen e vendeve të grumbullimit, kurse në të njëjtën kohë është kryer mbrojtja e kanalit kryesor atmosferik me profil 1.500 milimetra, gjatë të cilit janë vendosur më shumë mbrojtës prej betoni të armuar.

Projekti vazhdon të realizohet sipas dinamikës së parashikuar ndërtimore deri në ndërtimin e trasesë së plotë prej 1.700 metra. Punët ndërtimore do t'i realizojë firma "Mavrovo inxhiniering", kurse mjetet

me vlerë prej 120 milion denarë, sa do të kushtojë ndërtimi i rrugës me rregullimin dhe vendosjen e ndriçimit të ri, i siguroi tërësisht Qyteti i Shkupit.



KRYETARI KOCE TRAJANOVSKI VIZITOI LIDHJEN E TË VERBËRVE TË QYTETIT TË SHKLUPIT



Në suazat e shënimit të 15 tetorit, Ditës ndërkombëtare të Shkupit të bardhë, kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, vizitoi ambientet e Lidhjes së të verbërve të Qytetit të Shkupit dhe u takua me anëtarët e Lidhjes.

- Qyteti i Shkupit në mënyrë maksimale përkrah aktivitetet e kësaj shoqate. Këtë ditë dua të theksoj bashkëpunimin e mirë që ka Qyteti i Shkupit me Lidhjen e të verbërve dhe të theksoj se në vitin e ardhshëm ky bashkëpunim do të intensifikohet – tha kryetari Trajanovski gjatë vizitës në Lidhjen e të verbërve të Qytetit të Shkupit.

Kryetari i shoqatës së të verbërve të Qytetit të Shkupit, Zoran Kostadinovski, falënderoi kryetarin Trajanovski për rregullimin e hyrjes për në selinë e Lidhjes së të verbërve të Qytetit të Shkupit, për ndihmën e deritanishme financiare, për biletat e autobusit falas për shfrytëzimin e privilegjuar të transportit publik të 271 anëtarëve të tyre dhe për përkrahjen gjatë mbajtjes së manifestimeve kulturore të cilat i organizon shoqata.

U ASFALTUAN KORSITË TE URA “8 SEPTEMVRI”



Ekipet e NP “Rrugë dhe rrugica” përfunduan asfaltimin e korsive të këmbësorëve dhe për biçikleta në dy anët e urës “8 Shtetpvi” në afërsi të hotelit “Aleksandar Palas”.

Sipërfaqja e plotë e asfaltuar e korsive në të dy anët e urës është 1.500 metra katror, kurse për asfaltimin e tyre u përdorën gjithsej 210 ton masë asfalti. Korsitë janë në një gjatësi prej 126 metra dhe gjerësi prej 5,74 metra, kurse shtresa e asfaltit të vendosur ka trashësi prej 5 centimetra.

Me këto aktivitete, përfundon plotësisht rikonstruksioni i urës “8 Shtetpvi” i parashikuar me programin e Qytetit të Shkupit i cili përfshiu ndryshimin e kapakëve mbulues prej beton arme me kapakë të rinj sipas dimensioneve, riparimin e trarëve dhe vendosjen e shtyllave mbrojtëse me emblemën e Qytetit të Shkupit përgjatë urës.

QYTETI I SHKUPIT PËRGATITËT PËR DIMRIN QË VJEN

Qyteti i Shkupit ndau përkrahje financiare me vlerë prej 60 milion denarë për funksionimin e shërbimit dimëror për periudhën nga 15 nëntori deri më 15 mars të vitit 2010.

Ky vendim, së bashku me planin e përgjithshëm për punë në rrugët magjistrale dhe mbledhëse, mjetet e nevojshme teknike, si dhe strukturën dhe vendosjen e shërbimit, janë pjesë e Programit për punë të shërbimit dimëror të Qytetit të Shkupit në kushte dimërore 2009/2010, i cili u miratua nga Këshilli i Qytetit të Shkupit.



INTERES I MADH PËR DARJEN FIDANËVE

Në aksionin tradicional për ndarjen e fidanëve të gjithë qytetarëve të interesuar (këshillat e banesave) institucioneve kulturore, shëndetësore arsimore dhe publike, arritën mbi 180 fletë paraqitje nga subjektet e interesuara. Në këtë aksion planifikohet të ndahen 4.000 fidanë, nga gjithsej 35 lloje drurësh halorë, gjetherënës dhe kaçubë.

Shpallja për aksionin përfundoi më 9 nëntor. Pas miratimi të kërkesës, subjektet mund të marrin fidanët në periudhën nga data 9 deri më 30 nëntor në hapësirat e "Florakom" në fidanishten Butel dhe në NP "Higjiena komunale".

Aksioni i Qytetit të Shkupit për ndarjen e fidanëve organizohet vite më parë. Çdo vit ndahen drurë në një vlerë prej dy milion denarë, të ndara në dy etapa, në pranverë dhe në vjeshtë. Pranverën e kaluar qytetarëve të interesuar (këshillave të banesave) dhe institucioneve publike iu ndanë 1.500 fidanë, kurse deri te Qyteti i Shkupit u dorëzuan gjithsej 90 kërkesa.

Aksioni për ndarjen e fidanëve do të vazhdojë edhe pranverën e ardhshme.

PËRCAKTOHET ÇMIMI MË I LARTË I BLERJES SË TRUALLIT PËR NEVOJAT E VARREZAVE

Këshilli i Qytetit të Shkupit miratoi vendimin për përcaktimin e vlerës më të lartë të mjeteve për blerjen e truallit për nevojat e Varrezave në Shkup. Me këtë vendim të Këshillit të Qytetit të Shkupit, përcaktohet çmimi më i lartë i mjeteve për blerjen e truallit në vlerë prej 1.200 denarë për metër katror, që qyteti mund të ofrojë dhe paguajë në procedurën për blerjen e truallit të destinuar për zgjerimin e varrezave në Shkup.

Ky vendim u soll për shkak të rritjes së efektivitetit gjatë ballafaqimit me problemet e pronësisë-juridike me të cilat ndeshet Qyteti i Shkupit gjatë blerjes së truallit për zgjerimin e sipërfaqeve të varrezave në Shkup.

U PASTRUAN 3.800 KUBIK LYMISHTË NGA SHTRATI I LUMIT VARDAR

Nga 5.000 metra kub të parashikuara lym lumi, llum dhe mbeturina nga shtrati i Vardarit ekipet e NP "Rugë dhe rrugica" deri tani kanë pastruar 3.800 metra kub lymishtë në suazat e fazës së dytë dhe të tretë të aksionit të madh për pastrimin e shtratit të lumit Vardar. Këto ditë aksioni u ndërpre për shkak të rritjes së nivelit të ujit.

Aktivitetet e ndërmarrjes publike përfshinë pastrimin me makineri të pjerrësive të shtratit, pastrimin e gërmimeve dhe

transportin e lymishtës me kamionë deri në lokacionin adekuat. U pastrua bregu i majtë dhe i djathtë i shtratit të lumit Vardar nga ura e hekurit tek AMSHA deri te ura tek Stacioni i ri hekurudhor. Në këtë drejtim u shfrytëzua niveli i ulët i ujit të lumit Vardar që mundësoi hyrjen e pandërprerë të mekanizimit të specializuar për këtë qëllim, ku u sheshuan 3.000 metra kub lymishtë dhe u mbuluan të gjitha gropat dhe vendet jo të rrafshëta në fundin e shtratit në këtë drejtim.



U VENDOSËN STOLA TEK SHTËPIA E MALLRAVE "MOST"

Ekipet e NP "Rugë dhe rrugica" vendosën 6 stola në korsinë për këmbësorë në anën e majtë të bulevardit Goce Delçev, në afërsi të shtëpisë së mallrave "Most". Stolat janë vendosur nga tre në dy lokacione në korsi me qëllim mundësimin e parkimit të automjeteve motorike dhe për të lehtësuar lëvizjen e biçikletave dhe këmbësorëve.

Stolat metalikë të vendosur janë me lartësi prej 1 metër dhe me diametër Ø 100.

Më parë, stola të tillë, gjithsej 12, u vendosën në bulevardin Goce Delçev, në hyrjen e parkingut tek monumenti i Skënderbeut.

QYTETI SHKUPIT DHA DONACION PREJ 500.000 DENARË PËR MANASTIRIN "SHËN. JOVAN BIGORSKI"

Si propozim i të gjitha grupeve këshilltare, Këshilli i Qytetit të Shkupit solli vendim për donacion të njëhershëm për manastirin "Shën. Jovan Bigorski".

Donacioni i Qytetit të Shkupit ka një vlerë prej 500.000 denarë dhe është i destinuar për riparimin e dëmeve të shkaktuara nga zjarri që ndodhi më 30 shtator. Në zjarrin që ndodhi u shkaktua dëm në vlerë prej 5.5 milion euro, kurse u shkatërruan përgjithmonë objekte dhe sende vlera historike dhe kulturore e të cilave është e pallogaritshme.

TAKIMI I KATËRT I TRUPIT KOORDINUES TË KRYETARËVE TË KOMUNAVE

Propozimet e komunave dhe prioritet e tyre për Buxhetin e Qytetit të Shkupit për vitin 2010, mbledhja e mbeturinave, komunale, si dhe informacionet në lidhje me pagimin dhe ndarjen e vendimeve për tatim mbi pronën, ishin tema kryesore të seancës së katërt të Trupit koordinues të kryetarëve të komunave të Shkupit, e cila u mbajt nga fundi i muajit të kaluar.

Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, deklaroi se komunat nëpërmjet propozimeve dhe ideve të tyre duhet të marrin pjesë në përgatitjen e Buxhetit të Qytetit të Shkupit për vitin 2010.

Në komunikimin e përbashkët komunat duhet të na dorëzojnë prioritet dhe projektet prioritare, të cilat realizohen në territorin e komunave të tyre, kurse janë në kompetencat e Qytetit të Shkupit dhe duhet të financohen nga Qyteti i Shkupit — tha kryetari Koce Trajanovski.

Në trupin koordinues të kryetarëve të komunave u bë fjalë edhe për funksionimin e shërbimit dimëror në qytet, si dhe për procesin e ndryshimit të Planit të përgjithshëm urbanistik të Shkupit.

U MIRATUA REBALANCI I BUXHETIT TË QYTETIT TË SHKUPIT PËR VITIN 2009

Këshilli i Qytetit të Shkupit në seancën e tetë e cila u mbajt më 14 tetor të këtij viti miratoi propozim-ndryshimin e Buxhetit të Qytetit të Shkupit për vitin 2009, si dhe propozim-ndryshimin dhe plotësimin e Planit të programeve për zhvillim për periudhën 2009-2011.

Me sjelljen e këtyre vendimeve, Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2009 u zvogëlua për rreth 270 milion denarë.

GJALLËRO SHKUPIN, GJALLËRO SARAJIN

Mbi tetëqind nxënës nga 21 shkolla të mesme të Qytetit të Shkupit në fillim të tetorit morën pjesë në garat sportive që u mbajtën në suazat e manifestimit "GJALLËRO SHKUPIN, GJALLËRO SARAJIN" në Qendrën rekreative sportive "Saraj. Krosi, volejboli në rërë, hendbolli, basketbolli dhe futbollit ishin vetëm një pjesë e disiplinave në të cilat garuan nxënësit e shkollave të mesme të Shkupit.

Vitin e ardhshëm në maj në vendin tonë do të mbahet Olimpiada sportive në të cilën do të marrin pjesë nxënësit e shkollave të mesme nga e gjithë Maqedonia. Pikërisht për këtë do të shfrytëzoj këtë rast që t'ju rekomandoj ta shfrytëzoni këtë vit shkollor për përgatitje dhe në maj të keni formuar ekupe për Olimpiadën e ardhshme. Qëllimi i Qytetit të Shkupit është që të krijohen gjenerata të shëndetshme, dhe këtë mund ta arrijmë vetëm me pjesëmarrje aktive në ngjarjet sportive, sepse e ardhmja e vendit tonë është në duart e të rinjve që merren me sport dhe ruajnë shëndetin e tyre në këtë kohë urbane dhe moderne — i porosi kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski nxënësit e shkollave të mesme.



Manifestimi "GJALLËRO SHKUPIN, GJALLËRO SARAJIN" është pjesë e projektit "PO për miqësinë - JO për dhunën" dhe ka për qëllim të kontribuojë për përmirësimin e marrëdhënieve multietnike ndërmjet nxënësve të shkollave të mesme të Qytetit të Shkupit.

"GJALLËRO SHKUPIN, GJALLËRO SARAJIN" mbahet për herë të dytë, nën organizimin e Qytetit të Shkupit.



NË "VINO-SKOP 2009" U PINË 28.000 LITRA VERË

Në festivalin e tretë ndërkombëtar për promovimin e verës "Vino-Skop 2009" që u mbajt nga data 15 deri më 18 tetor në sheshin "Maqedonia" u pinë 28.000 litra verë. Festivali u vizitua nga 60.000 mysafirë, që tregon se pjesëmarrja në festivalin e sivjetmë "Vino-Skop" është

dyzet për qind më madhe në krahasim me vitin e kaluar.

Në festivalin e verës u paraqitën 35 kantina vere vendase dhe të huaja.

Shitja e verës dhe ushqimi u organizua nëpërmjet kuponave në vlerë prej 30, 50, 100 dhe 200 denarë.



KRYETARI KOCE TRAJANOVSKI PRITI PJESËMARRËSIT E ULTRAMARATONËS PËR NDER TË TOSHE PROESKIT

Ultramaratonistët të cilët vrapuan nga Nova Gradishka në Kroaci deri në Krushevë dhe në këtë mënyrë shënuan dy vjetorin e vdekjes së pop-ikonës maqedonase Toshe Proeski, më 18 tetor në sheshin "Maqedonia" i priti Kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski. Kryetari u dëshiroi mirëseardhjen e ngrohtë maratonistëve në Shkup dhe përshëndeti veprën e tyre të madhe.

Ultramaratonistët kryetarit Trajanovski

i dorëzuan mirënjohje dhe bust nga Fondacioni ndërkombëtar "Toshe Proeski" – Krushevë.

Ultramaratoni për Toshën është nën organizimin e Fondacionit ndërkombëtar "Toshe Proeski" – Krushevë dhe Fan klubit të Toshe nga Republika e Maqedonisë. Këtë vit në ultramaraton morën pjesë pesëmbëdhjetë maratonistët më të mirë nga më shumë klube të atletikës nga Republika e Maqedonisë.

U VENDOSËN DY TABELA INFORMATIVE PËR STACIONARIN "VARDARISHTË"

Ekipet e NP "Higjiena komunale" në rrugën hyrëse deri te rruga Pero Nakov drejt stacionarit "Vardarishte" vendosi dy tabela informative të cilat do të ndihmojnë qytetarët e interesuar më lehtë të gjejnë Stacionarin për trajtimin human dhe kontrollin e qenve endacakë.

Në tabelë është shkruar numri i telefonit pa pagesë i Stacionarit "Vardarishte" 8201-315 dhe Faqja-internet e NP "Higjiena komunale" ku mund të merren të gjitha informatat plotësuese.



PASTROHEN VENDET E GRUMBULLIMIT TË KANALIZIMIT ATMOSFERIK

Ekipet e NP "Ujësjellës dhe kanalizim" këto ditë po pastrojnë vendet e grumbullimit të kanalizimit atmosferik nga gjethet e rena. Në kryerjen e këtyre aktiviteteve sezonale është

përfshirë mekanizimi i plotë, cisternat vakum dhe sipas nevojës edhe cisternat nën tryzni.

Në pastrimin e vendeve të grumbullimit janë përfshirë edhe punëtorët e angazhuar për kohësisht nga Qyteti i Shkupit dhe nga Agjencia për punësim (në përputhje me Projektin për organizimin e punëve publike në furnizimin me ujë dhe përcjelljen e ujërave fekale).

PËRSËRI VENDOSËN ÇMIMET PËR EKSPONATET MË TË MIRA TË "MAKINANOVA 2009" DHE "EKONOVA"

Pas një pauze disavjeçare, "Çmimi i Kryetarit të Qytetit të Shkupit" për eksponatet më të mira nga ekspozita ndërkombëtare e inovacioneve, avancimeve teknike, prodhimeve të reja dhe krijimtarisë së të rinjve – "Makinova 2009" dhe ekspozitës ndërkombëtare të avancimeve teknike dhe inovacioneve nga fusha e ambientit jetësor "EKONOVA" këtë vit u vendos përsëri.

Laureat i "Çmimi i Kryetarit të Qytetit të Shkupit" – Makinova 2009 është autori Nikolla Burçevski për eksponatin – Mikro kontrollor.

Laureat i "Çmimi i Kryetarit të Qytetit të Shkupit" – Ekonova 2009 është Vele Nikollovski për eksponatin – Ekosistem për ndërtim.

– Është nder i madh për mua që traditën për çmimin e Kryetarit të Qytetit të Shkupit për inovacione dhe zgjidhje kreative, të prezantuar në suazat e manifestimit MAKINONOVA e rinovojmë përsëri në Vitin evropian të kreativitetit dhe inovacioneve, që është edhe një dëshmi për përkushtimin tonë për nxitjen dhe promovimin e kreativitetit – theksoi kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski në ndarjen e çmimeve.

Laureatët e çmimeve janë përcaktuar me vendim të komisionit vlerësues ndërkombëtar, kurse eksponatet u vlerësuan sipas këtyre kriterëve: origjinaliteti i inovacionit, ekzistenca e hapit inventiv, zbatimi industrial, shkathtësia në prezantim dhe mundësia për komercializëm.

Këto dy manifestime mbahen në suazat e Panairit ndërkombëtar të metalurgjisë, elektronikës, jometaleve dhe ndërtimtarisë "TEHNOMA".

DONOHEN PAJISJE SEMAFORIKE PËR PRILEPIN, KAVADARIN DHE KOÇANIN

Qyteti i Shkupit do të donojë një pjesë të lanserëve të vjetër semaforik komunave Prilep, Kavadar dhe Koçani, vendosi Këshilli i Qytetit të Shkupit.

Bëhet fjalë për lanterë semaforik të gjeneratës më të vjetër që janë shumë më të vështirë për servisim dhe për mirëmbajtje në gjendje të rregullt dhe operative dhe që gradualisht po hiqen nga rrugët e Shkupit.



Qyteti i Shkupit filloi projektin pilot për kompostim

GJETHET E RËNA DO TË SHNDËRROHEN NË PLEH NATYRAL ME KUALITET

Gjethet e rëna të cilat mblihen nga sipërfaqet e gjelbra publike do të shndërrohen në pleh natyral me kualitet – komposto në projektin pilot për kompostim që javën e kaluar e filloi Qyteti i Shkupit dhe NP “Parqe dhe gjelbërim”. Për këtë qëllim, në oborrin e NP “Parqe dhe gjelbërim” është hapur një gropë me dimensione 30 x 30 metra dhe thellësi 1,5 metër në të cilën do të derdhen gjethet të pastruara nga mbeturinat e tjera që mblihen nga sipërfaqet e gjelbra (degë, letra dhe plastikë). Gjethet e grumbulluara në mënyrë natyrale do të kalben dhe do të shndërrohen në pleh, i cili do të shfrytëzohet për nevojat e NP

“Parqe dhe gjelbërim”. Kompostojat pritet të formohet për rreth një vit.

- Gjethet e grumbulluara nga sipërfaqet e gjelbra në qytet ndërmarrja publike “Parqe dhe gjelbërim” deri tani i çonte në depon “Drisla”. Nga sipërfaqet e gjelbra në qytet në vit mblihen rreth 150 ton masë gjethore. Me këtë krijohen shpenzime të mëdha për transportin dhe deponimin e gjethëve. Me këtë projekt pilot për kompostim, ndërmarrja publike “Parqe dhe gjelbërim” do të prodhojë pleh natyral me kualitet për nevojat e veta dhe do të zvogëlojë shpenzimet për transport dhe për deponim. Në këtë mënyrë do të

realizohet një kursim prej 2 milion denarë. Projektin për kompostim do ta plotësojmë edhe më tej. Do të ndërmarrim iniciativë për të nxitur qytetarët që jetojnë në shtëpi private të kompostojnë mbeturinat e gjelbra nga oborret e tyre dhe të kursejnë – tha kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, në promovimin e projekt pilotit për kompostim.

Kompostimi përbën shpërbërje të kontrolluar biologjike të materieve organike në praninë e oksigjenit dhe nën veprimin e mikroorganizmave dhe gjatë këtij procesi fitohet komposto-pleh organik me kualitet të lartë.



LAUREATË TË ÇMIMIT "13 NËNTORI" TË QYTETIT TË SHKUPIT

Këshilli për ndarjen e çmimit prestigjioz të qytetit "13 Nëntori" që tradicionalisht ndahet në festën e qytetit – 13 Nëntori, solli vendim çmimin e mirënjohur të Qytetit të Shkupit për vitin 2009 t'ua ndajë:

I. Nga fusha e **ARSIMIT DHE EDUKIMIT**

- **SHKOLLA E MESME E QYTETIT TË SHKUPIT „MARIJA KYRI SKLODOVSKA” – SHKUP**
(për kontribut të veçantë në përparimin e veprimtarisë edukative arsimore)

II. Nga fusha e **KULTURËS**

- **Prof. GORDANA JOSIFOVA- NEDELKOVSKA**
(artist muzikor – për arritje të larta në skenën muzikore maqedonase dhe ndërkombëtare)
- **DREJTORIA PËR KULTURË DHE ART E SHKUPIT**
(për afirmim shumëvjeçar në kontinuitet të krijimtarisë kulturore në Shkup)

III. Nga fusha e **ARTIT**

- **SIMON TRPÇEVSKI**
(artist muzikor, pianist, për arritje muzikore të larta në vend dhe në botë)

IV. Nga fusha e **MBROJTJES SHËNDETËSORE**

- **Prim. dr. PETAR KRONEVSKI**
(kirurg maksilofacial – për punë shumëvjeçare në fushën e shëndetësisë)
- **Spitali special për sëmundje kirurgjikale „FILIP I DYTË”**
(për arritje cilësore në fushën e kardiokirurgjisë)

V. Nga fusha e **ARKITEKTURËS DHE NDËRTIMTARISË**

- **KOSTA ZEKMANOVSKI**
(Inxh. nd. i dip. i punësuar në Qytetin e Shkupit – për arritje të veçanta në ndërtimin e infrastrukturës rrugore dhe avancimin e rregullimit komunal në Shkup)
- **KOLE JORDANOVSKI**
(inxhinier ndërtimi në pension – për kontribut të veçantë në zhvillimin e Shkupit pas tërmetit të vitit 1963)

VI. Nga fusha e **BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR**

- **Prof. Dr. VOLFGANG RAJZER nga Republika Federale e Gjermanisë**
(për kontribut të veçantë në fushën e kardiologjisë invazive dhe intervente në Republikën e Maqedonisë)
- **Docent dr. KNEGINJA RIHTER - SOKOLOVSKA**
(për përparimin e shëndetit mental dhe për ndihmën teknike dhe financiare për qytetin e Shkupit)

VII. **NXËNËS DHE DTUDENTË**

- **VASIL KUZEVSKI**
(nxënës në klasën e tetë në SHF „Dimo Haxhi Dimov” – Shkup, për sukses të shkëlqyer në kontinuitet dhe pjesëmarrje aktive në aktivitetet shkollore dhe jashtëshkollore dhe rezultate të arritura në garat ndërkombëtare të matematikës, republikane dhe regjionale)
- **MIHAJLO GJEORGJIEVSKI**
(student në Fakultetin e mjekësisë – Shkup, për sukses të shkëlqyer në kontinuitet dhe pjesëmarrje aktive në aktivitetet shkollore dhe jashtëshkollore dhe rezultate të shkëlqyera të arritura në Fakultetin e mjekësisë në Shkup)

Këshilli për ndarjen e Çmimit "13 Nëntori" të Qytetit të Shkupit për vitin 2009 përbëhet prej 11 anëtarësh. Nga dyzet letra të vlefshme, në bazë të Rregullores për Çmimin "13 Nëntori" edhe këtë vit çmimin e marrin kandidatët të cilët kanë marrë të paktën dy të tretat e votave të anëtarëve të Këshillit për ndarjen e Çmimit "13 Nëntori" të Qytetit të Shkupit për vitin 2009.

Akuadukti i Shkupit

